



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 194, datë 16.12.2020

PËR

MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “NEXIA AL” SH.P.K., PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË “ALBSIG INVEST” SH.A. PËR VITET 2019 DHE 2020, SI DHE TË FONDEVE QË ADMINISTROHEN PREJ SAJ PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2020

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar” dhe Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjes të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I :

- 1. Miratimin e ndryshimit të shoqërisë audituese “Mazars Albania” sh.p.k., me shoqërinë audituese “Nexia AL” sh.p.k., për shoqërinë administruese “Albsig Invest” sh.a.**
- 2. Miratimin e shoqërisë audituese “Nexia AL” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Albsig Invest” sh.a. për vitet 2019 dhe 2020, si dhe të fondeve që administrohen prej saj, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2020.**
- 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**ANËTAR
Deniz DERALLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**